



Shkruan: Fatlum Sadiku

Pa dashur të cilësoj apo/dhe të flas nisur nga premisa nacionaliste apo "shqiptaro-mëdha", është mëse e vërtetshme se kohëve të fundit, rryma serbofile shqiptare është riaktivuar me të madhe me ligjërimet e saj gojore, në shtyp si dhe në internet. Se ekziston një rrymë serbofile shqiptare, ky nuk është një cilësorim aloglot denigures, por i zbërthyeshëm e i dekonstruktuar socio-psikologjikisht, si një cilësorim adekuat e i qëndrueshëm. Si shkak fundamental i riaktivizimit të kësaj rryme, është rritja gjithnjë e më e theksuar e ndikimit turk në Kosovë, kryesisht në rrafshin ekonomik, por edhe në atë kulturor e politik. Është interesante se si reagimet ndaj zgjerimit të ndikimit turk, po mbipeshojnë ndaj reagueime mbi ndikimin serb në Kosovë, korrupsionit qeveritar, humbjeve ekonomike të Kosovës nga kontrabanda, getozimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, bisedimeve me Beogradin që dita ditës duket se do ta hapin edhe çëshjen e veriut, vizitave politike të liderëve serbë pa pyetur pothuajse asnjëherë autoritetet kosovare, deklaratave politike të Klerikëve ortodoksë serbë e atyre katolikë shqiptarë, reagueime këto që pasqyrojnë se sa i thellë është pushtimi shpirtëror, përkatësisht penetrimi i inercionit serbofil tek individët e rrymës në fjalë...

Fundamentet e anti-turqizmit: osmanofobia, islamofobia...

Anti-turqit janë osmanofobë. Kjo është krejtësisht e qartë. Ata kanë mësuar në shkollë se "shqiptarët", kanë qenë katolikë dhe se me dhunë u kthyen në Islam. Po t'u thuash se paraardhësit e shqiptarëve me shumicë dërmuese ishin ortodoksë, pra që kishin fenë e njejtë me atë serbëve – nuk e besojnë. Nacional-katolicizmi shkollor e ka bërë të veten. Madje edhe vetë komunizmi 50 vjeçar enverist, që në anipse ishte version i stalinizmit shqiptar, në fakt si çdo komunizëm tjetër, ishte i ardhur nga Europa, ku lindi edhe vetë komunizmi si ideologji – ndaj që origjinarisht ishte eurokomunizëm, nisur nga vetë fakti se Enveri fillimisht erdhi dhe i'u bashkua grupit komunist të Korçës nga Franca, duke vënë në jetë mësimet komuniste franceze. Dhe shikuar me dioptrinë realiste edhe Enveri edhe Titoja (në Jugosllavinë si supra-shtet AVNOJ-ist, por edhe në republikat e krahinave të veçta), kanë ndërtuar shtete mbi bazat e shekullarizmit immanent (Esposito), evropian: shtete-nacionale dhe shekulare, që në post-monizëm, u pushtuan nga ndikimi në rritje i fesë. Në rastin e Kosovës, i tillë ishte rugovizmi bogdanist, që si ideologji e vet prijësit të saj, Pjetër Rugovës, hyjnzonte ushtarin e serbëve Pjetër Bogdanin, dhe luftën e tij kundër osmanëve dhe muslimanëve më 1689. Kombinatorika nomosale e këtyre ideologjive dhe botëkuptimeve të forta, janë bazat e osmanofobisë dhe anti-turqizmit. Janë relikua që nuk shihen dot nga trutë e shkërdhthyer të serbofileve shqiptarë. Por përse, osmanofobia dhe anti-turqizmi, në thelb janë resentimente anti-Islame? Hajde për hire të Zotit të bëhemi real, të trija palët: vetë anti-turqit, ne si pro-turqë por edhe lexuesit e thjeshtë e neutral dhe të përgjigjemi bashkarisht: po të ishin turqit të krishterë, a do të ekzistonte ndjenjat anti-turke të shqiptarëve që sot çjerren kundër tyre? Unë them se kurrën e kurrës! Sepse urreja ndaj turqëve pothuajse fare nuk është etnike, por në esencë krejtësisht fetare. Sepse edhe bullgarët janë me origjinë etnike fis turk, dhe si të tillë erdhën në Ballkan në kohën e Asparuhut, para se të sillavizoheshin dhe të pranonin krishterimin. Ishin katër here pushtues të elementit arbëro-shqiptar në Ballkan. Por ndaj tyre rryma serbofile shqiptare heshëte. Edhe hungarezët vijnë origjinarisht nga familja ungro-fine dhe pjesërisht ishin fis turk. Edhe këta ishin pushtues. Edhe ndaj tyre - heshëte varri nga serbofilet shqiptarë. Edhe finlandezët origjinarisht vijnë nga stepat e Mongolisë. Ahisaari, që me planin e tij vuri bazat e ndarjes së brendshme të Kosovës është finlandez. Përjashto "Vetëvendosjen", shqiptarët serbofile asnjëherë nuk kanë shfaqur vërejtje ndaj Pakos së Ahisaarit, duke qenë të zënë vetëm dhe vetëm me turqit, që i urrejnë si muslimanë.

Ksenomania nacional-europianiste si kamoflim i anti-turqizmit. Mendësia e Teodosit dhe Jaltës si relikua kristiane/komuniste e kolonialiste

Anti-turqizmi i fundmentuar mbi islamofobi, e që fshihet pas auroles europianiste, në fakt nuk e ka përjetuar kurrë europlanizmin që është ende në kërkim të eklipsimit të identitetit të tij. Prandaj s'ka se si që kristian-komunistët e shkërdhthyer në tru të jenë më evropian se evropianët akoma të papërfunduar në union. Thirrja në ndasinë e prerë si me thikë: Perendim/Lindje, është thirrje në mendësinë e trashëguar pikërisht nga tri produktet më të tmerrshme që prodhoi Europa e krishterë si kontinent: gjakatarë të mesjetarë të Kishës, fashizmin e komunizmin, si dhe kolonializmin. Sepse ishte pikërisht skizma kishtare e vitit 1054 ajo që krijoi ndasinë Lindje/Perendim, respektivisht "Vijën e Teodosit", në Europë, të cilën nuk e krijoi rreziku musliman, sepse muslimanët kishin shkelur në Spanjë 350 vite para llatarisjeve brenda-krishtere duke ndërtuar e ndritur Europën me qytetërim e dituri. Së dyti, është nacionalizmi e më pas nazi-fashizmi, ai që mëtoi t'i imponohet botës me ekspansion të theksuar në Lindje; përkatësisht komunizmi i dalur kryesisht pas Jaltës, ai që konstruktiv mendësinë e siprorësisë së "perendimit të mirë" ndaj "lindjes së keqe", si dhe thënë më përgjithësisht me një fjalë, është mentaliteti kolonialist - gati dy shekullor - mbi bazat e një orientalizmi islamofob (Edward Said), ai që e ka ndikuar më së shumti në forcimin e bindjeve negative dhe armiqësore ndaj Lindjes. Por rryma serbofile shqiptare, si anti-Islame dhe anti-turke që është, i ka mjaft mirë të pikëtuat "armiqët e Lindjes", ndaj që edhe kur fshihet pas justifikimeve "civilizuese" perendimore, duke etiketuar lindjen "si të keqe", ajo në fakt nuk etiketon tërë lindjen, por me "lindje" etiketon indirekt pikërisht Islamit, muslimanët, arabët, vendet muslimane, Turqinë, turqit, e Perandorinë Ineksistente Osmane, si të padëshiruara. Jo Rusinë. As Kinën. As Rumaninë – si tri shtetet më avokate të Serbisë. Prandaj kjo rrymë është e tillë çfarë është: SERBOFILE, sepse heshëte, e kursen, dhe E DO Serbinë, respektivisht dominimin dhe hegjemoninë e saj e në planin brendshëm dhe të jashtëm. Brenda kufirjëve të Kosovës dhe në rajon. Rryma serbofile shqiptare, do t'ia mbulon të gjitha lëshimet Thaçit, po të ftohej ai për vizitë në Izrael. Por ja që shteti-gjenocidal çift, akoma mbetet një ndër shtetet më besnike të Serbisë, siç ishte para, gjatë dhe pas luftërave në ish-Jugosllavi dhe nuk e fton Thaçin dhe askë prej politikantëve kosovarë. Këtë po e bëjnë vetëm liderët e shtetit tone vëlla të Turqisë, me apo pa dëshirën e serbofileve shqiptarë. E rëndësishme është që ndikimi dhe roli turk, falë Allahut po rikthehen, dhe atë jo në formën e ndonjë nacionalizmi ekspansionist turk, por në formën e një zgjerimi bazar mbi parime të konkurrencës demokratike dhe të urrejtjes Islame. Dhe ne si nipër të ottomanëve e presim këtë realitet krahhëpaur. Është mos-mirënjohje e pafalshme për buzia ndaj ndihmave që shteti turk po u ofron shqiptarëve, në panumërsisht raste. Dhe duket se është shumë e nevojshme që resentimentet anti-muslimane e anti-shqiptare, të rripërsëriten nga Stefan Lorenët e ri të EULEX-it të dështuar.

/ekullibri/